



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 63.4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë,
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datë 21.10.2020, merr këtë:



V E N D I M

Për refuzimin e kërkesës së Partisë Socialdemokrate

- I. Aprovohet rekomandimi i Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim për refuzimin e kërkesës së partisë politike Partia Social Demokrate për ndryshim të llogos (shenjës).
- II. Obligohet Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim të njoftoj Partinë Socialdemokrate në lidhje me këtë vendim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim ka pranuar kërkesën për ndryshim të llogos (shenjës) nga Partia Socialdemokrate. Llogoja (shenja) e partisë politike është një prej kriterëve që duhet përmbushur me rastin e regjistrimit të partisë politike andaj ky rast është trajtuar sipas legjislacionit në fuqi që rregullon fushën e regjistrimit të partive politike. Pas pranimit të kësaj kërkesë, Zyra ka kontrolluar dokumentacionin e dorëzuar së bashku me këtë kërkesë dhe ka vërejtur që procedura e përcjellur për të ndryshuar llogon e partisë nuk është në përputhje me procedurat e brendshme të partisë politike të definuara në Statutin e tyre më saktësisht neni 7. Andaj duke u bazuar në këto të gjetura, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi si në dispozitiv.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Valdete Daka, Kryetare

Këshillë juridike: Partia Politike, "Partia Socialdemokrate" me akronimin PSD, ka të drejtë ankese në Panelin Zgjedhore për Ankesa dhe Parashpresa – PZAP, brenda 24 orëve nga pranimi i këtij vendimi të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.